



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 20 Prot.

Rrogozhinë, më 17.03.2026

VENDIM

Nr. 17 , datë 17.03.2026

**PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE TË
BASHKISË RROGOZHINË PËR VITIN 2026-2028**

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës me datë 17.03.2026 analizoi dhe diskutoi në lidhje me projekt-vendimin e ardhur nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.708.Prot datë 16.02.2026 “Për miratimin e planit vendor të veprimit për barazinë gjinore të bashkisë Rrogozhinë për vitin 2026-2028”, si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.708/1.Prot datë 16.02.2026.

Në mbështetje të nenit 18, nenit 24, nenit 54, nenit 55 të ligjit Nr.139/2015, datë. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” , i ndryshuar, të Ligjit Nr 64/2025 datë 06.11.2025 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, me propozim të zëvendëskryetarit të bashkisë ushtrues i detyrës së kryetarit, me 12 (dymbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Miratimin e planit vendor të veprimit për barazinë gjinore të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2026-2028 sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Efekti financiar është parashikuar në Buxhetin e bashkisë për vitin 2026 në zërin buxhetor 00/01/1110/6029099 në vlerën total 1 125 000 (një milion e njëqind e njëzet e pesë mijë) lekë.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Mbrojtjes dhe Kujdesit Social pranë Bashkisë Rrogozhinë
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

ZËVENDËSKRYETARI I KËSHILLIT

FRIND TOSKÛ



Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com